

BESIMTARI

Organ i Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Vitet I i botimit, Qershor 2007 Nr 2. Çmimi 20 lekë. www.gazetabesimtari.com



TELEKOMI PER TUROQIT MJAFT I DHAME ITALIANËVE DHE GREKËVE



eksperteve nderkombetare, ishte maksimumi qe mund te jepej per kete object. Qe kur ishte ne opozite, Partia Demokratike e kontestoi kete privatizim, duke deklaruar se eshte shitur lire dhe sapo te vije ne pushtet, ajo do ta anulloje kete kontrate te cilen e quajti abuzim financiar te Parties Socialiste. Per ato, qe percjellin me kujdes politiken shqiptare, rane kambanat e alarmit per prapavijen e kesaj qeverie, qe po pergaditej te merrte pushtetin, sepse, renia ne dore

vene ne qender te axhentes se saj ceshtjen Telekom duke bere anulimin e kontrates qe kishte bere qeveria e Nanos me motivin se ishte shitur shume lire.

Ishin mediat shqiptare qe e nxoren ne faqet e para te tyre vendimin e qeverise se Berishes duke i shtuar edhe nga veltja deshiren qe Telekomit mos te privatizohet nga turqit, por te kerkohen kliente te tjere shqiptare ose te huaj Edhe Partia Socialiste u be pjese e korit antiturk ku solist i pare do te ishte vete kryetari i ri i PS, Edi Rama

Duket se qeveria turke, se bashku me firmen Callik e shikoi vehten ne pozite te veshitire nga ky diskrimini i hapur qe po behej nga mediat dhe politika shqiptare e cila arriti kulmin kur kanali televiziv me antiqeveritar, Top Chenell, deklaroi i entuziasmuar se e vetmja fjale qe i mbajti Berisha elektoratit ishte prishja e kontrates me turqit. Duket se problemi i Telekomit tashme kishte marre karakter te theksuar politik, sepse mediat shqiptare e bene fjale te dites dhe ngjyra politike e ketij problemi arriti zenitin e tij kur Berisha beri nje vizite ne Turqi qe pa tjetër ishte ne pikat me te nxehta te axhentes se tij me z. Erdogan. Ato qe i ndoqen pamjet e vizites se Berishes ne Turqi, e pane qarte se atij ju rezervuanje pritje jo shume e ngrohete qe dukej edhe ne qendrimin tejet serjoz te z. Erdogan. Por, ne Turqi duket se Berishes i rane puplat dhe i dha rruge te sigurte kalimit te Telekomit tek Callik Kompani duke pranuar te dy palet te benin disa korigjime te nevojshme ne kontraten e shitjes. Tashme mediat shqiptare po heshtin dhe Telekomit nuk shihet neper lajmet e tyre, duke na bindur se beteja per Telekomin ka marre fund dhe ai ka rene ne dore te turqve

Ajo qe te ben pershtypje eshte shqetesimi qe kapi median dhe politiken shqiptare per kalimin Telekomit tek nje kompani turke, kur kemi parasysh se Turqia eshte investitori i trete ne ekonomine shqiptare pas Greqise dhe Italise qe thuaje e kane

Vijon faqe 2

Problem i privatizimit te sektoreve te ekonomise shqiptare eshte i nje rendesie te vecante, sepse me veprime dhe akte te tilla, ekonomia shqiptare vazhdon te beje hapa me rendesi ne drejtim te fuqizimit te sektorit privat ne Shqiperi duke i hapur keshtu rruge edhe me fuqishem sektorit privat qe eshte baza e ekonomise se tregut drejt te cilit ecen sot vendi yne Por, qe te behet mrenda rregullave ky privatizim, qeveria shqiptare ka pase para sysh kapacitetet monetare te kapitalit vendas dhe mbi bazen e ketij kapaciteti, ajo ka vendosur qe objektet strategjike do te privatizohen nga kapitali i huaj permes firmave qe do t'i plotesojne kriteret e vendosura nga qeveria shqiptare per privatizime te tilla. Nje objek i tille strategjik eshte edhe Telekomit shqiptar i cili u be nje problem qe u lakua ne media, ne parlament dhe ne sfera e larta te politikës shqiptare, sepse shtete qe kane zgjatur duart dhe qe kane depertuar ne te gjithe sferat e jetes ne Shqiperi, duket se kane krijuar edhe prapavijen qe mbron interesat e tyre. Pa u larguar nga tema, qe po trajtojme, kujtojme se qeveria socialiste e Fatos Nanos ia shiti Telekomin shoqerise turke "Callik Kompani" me nje cmim shume te larte, i cili, sipas



te turqve e Telekombit, do t, u vinte nje fre te forte fitimeve kolosale qe po realizonin dy kompanite celulare greke ne Shqiperi, qe me zvatjen qe po u bejne xhepave te shqiptarve, na kujtojme firmat famekeqe piramidale qe edhe keto lulezuan ne vitet kur ne pushtet ishte Partia Demokratike Sapo erdhi ne pushtet kjo parti, duket se e kishte

A KA ARDHË KOHA TË KEMI
ZGJEDHJE TË NDERSHME
KËTË RADHË NË KMSH?

Hadi Bushati

Fq 2

SHOQATAT MUSLIMANE JANE
TE PAVARURA
DHE TE APROVUARA ME LIGJ

Selim Gokaj

Fq 3

SEHIRXHINJ APO
POLITIKANE

H. Bashkim Bajraktari

Fq 3

ISLAMI PER
GJAKMARRJEN

Vehbi Dani

Fq 4

PUTINI DHE TEDESKINI

Bujar Shehu

Fq 5

PROTOKOLLET E SIONIT-
PLATFORME E SUNDIMIT
BOTEROR

Abdi Baleta

Fq 7

A ka ardhë koha të kemi zgjedhje të ndershme këtë radhë në KMSH?

Me datë 2 Qershor 2007 në Durrës u zhvillue mbledhja e radhës e KP të KMSH, ku u diskutuan probleme rutinë dhe si pikë që ngjalli diskutime ishte vendimi i Kryesisë se KMSH mbi shitjen e nje trualli ne qender te Tiranës. Ky vendim u quajt i nxituar dhe me pasojë dem ekonomik te konsideruar. Keshilli mbas debatesh arriti në perfundimin qe te gjenden rrugët e mundesitë e anulimit te shitjes duke realizuar zgjidhjen me te mirë të mundshme.

Në rendin e ditës ishte planifikuar dhe hapja e fushatës për zgjedhjet e radhës mbasi u mbushen 4 vjet e ne bazë të statutit duhen berë zgjedhjet e reja. Keto kane te bejnë me keshillat e xhamive, keshillat prane myftinive si dhe me organin vendimarrës KP te KMSH. Koha qe ju kushtue kesaj pikë te rendit te dites, ishte fare e vogël, sa kohë mund te marrë nje lajmërim. Mungesa e vleresimit te këtij momenti kyc per të ardhmen e KMSH është mungesë serioziteti i paramenduar.

Duke e quajtur shumë të rëndësishme fushatën per zgjedhje e ndjeva si obligim te proncohem publikisht per të ndihmuar sado pak qe këto zgjedhje te behën larg formalizmave, te jenë sa me të drejta dhe në perputhje me ligjin per organizatat jo fitimprurese, mbasi KMSH është me kete status. Realizimi i tyre ne perputhje me ligjin është edhe me i nevojshem, mbasi kemi mangësi dhe thyerje te ligjit te lartpermendur.

Per te arritë efikasitetin e tyre, zgjedhjet duhet te kenë një platformë te hartuar, e cila te ketë objektiva e kriteret te percaktuara, që duhet te plotesojnë te zgjedhurit (per nivel arismor, cilesitë personale, perkushtimin ndaj islamit etj) ne te gjitha shkallet, duke eliminuar formalizmin qe shpesh ka qenë dhe është present ne punët e Kryesisë te KMSH dhe te organeve vartëse. Mendoj se pergatitja konform ligjit parandalon hyrjen ne strukturat e KMSH te njerzëve qe rrinë gatitu para eprorit, qe sillen nga të fryej era si dhe njerëz "memeçë" sic jane vrejte ne ketë 4 vjecar. Ligji per organizatat jo fitim prurëse eshte i qartë dhe optimal që KMSH te realizojë zgjedhje te drejta, mjafton te dojë. . . Ne themel te ligjit është vlersimi i antarësise, qe është baza e asamblesë te pergjithëshme, që ka tagrin e organit më të larte te organizatës alias KMSH (ligji mbi organizatat jofitimprurëse me nr. 8788 dt 07/05/2001).

Ne statut, procedurat e zgjedhjeve te organeve vendimarrës nuk percaktojnë numrin e antarëve te këshillit te pergjithëshëm, sa antarë të organizatës duhet të perfaqesohen me nje antarë të KP. Gjate vitit parashikohen vetem dy mbledhje te zakonshme te KP qe janë për mendimin tim te pamjaftueshme në zhvillimin normal të veprimtarisë së KMSH. Vlen te theksohet se nga viti 2003 deri 2007 nuk është parë e aresyeshme te mblidhet KP në mbledhje te jashtëzakonshme.

Mungesa e mbledhjeve llogaridhëse ne KP nga aparati i KMSH e venë ne gjumë ate, shton mundesinë qe tv mos jenë transparente sepse problemeve te caktuara ju humb aktualiteti ;krijon shtratë te ngrohjet te zhvillimit te autoritarizmit nga



ekzekutivi në pergjithësi e në vecanti nga titullaret deri ne majë te piramides. Gjatë 4 vjeteve ka shembuj te mjaftueshem te cfaqjes se këtij fenomeni në cdo hallkë te KMSH nga lartë deri ne bazë. Eshtë logjike qe numri i mbledhjeve te shtohet, po të marrim parasysh problemet e pafundme me të cilat ndeshet KMSH e pse jo edhe me prezencen e mediave që per hire të vertetes nuk jane ftuar asnje herë. ne to.

I zgjedhuri i cilitdo rang është përfaqësues i antarësise dhe si i tillë ka një status qe ekzekutivi duhet ta njohë dhe ta respektojë

Te njetat probleme duhet te reflektohen ne myftini sepse vet myftinia ne vetvehete paraqet nje mini KMSH dhe kjo nuk është e imunizuar ndaj fenomeneve negative te cfaqura. , Te mos harrojmë se këshilli i myftinisë perbehet prej të zgjedhurve kurse drejtuesi, muftiu qoftë i rrethit apo i zonës, është i emëruar;këshillaret kanë nje tager te percaktuar nga ligji. Eshtë e pafalshme qe Z. muftilere nuk pyesin këshillin e myftinisë duke e anashkaluar plotesisht ate. Kjo perben shkelje te rendë duke marrë neëer kembë te drejtat e tyre. Shembuj te tillë janë verteturar ne zonën e Tiranës Shkodrës apo gjetcë. .

Ne statutin e KMSH, lidhur me votimin per vendimet e KP, thuhet "duhet të merren me shumicë 50%+1 dhe me pjesëmarrjen e mbi 2/3 të të gjithë anetarëve të KP" por duhet të ketë per raste te vecanta regulla qe t'i pergjigjet vendimit që do të votohet(fjala vjen zgjedhja e kryetarit te KMSH apo marrëveshtje shumë të rëndësishme), dhe menyres se kryerjes te ketij votimi(me karton, me shkrim). Aktualisht me pjesemarrjen e cilesinee antareve te KP, Kryesia e KMSH arrin te aprovoje me karton cdo

vendim te marrun nga ana e saj, e thene ndryshe, manipulon ne menyre te" ligjeruar. " Ne KP jane antare me te drejte vote 42 rrogetare qe me urdher te pa shkruar marrin pjese ne mbledhje dhe qe perbejne ne cdo rast 50%+1 te 2/3 te nr te pergjitheshem te KP te nevojshem per zhvillimin e mbledhjes. Ne gjuhen e zakonshme KP ka ne gjiren e vete llogari dhenesit qe jane rrogetaret (muftileret dhe drejtoret) dhe llogari kerkuesit qe jane po ata antare (myftilere dhe drejtore) te gjithë te emruar. nga kryesia e KMSH.

Sic thote populli vet Ali dhe vet kadi. prandaj raporti i te zgjedhurve ndaj te emruareve ne KP duhet te studjohet. , qe perfaqesuesit te antaresise te jene ne krye e jo ne bisht te situates dhe kjo te jete e shkruar qarte ne statut.

Shtojme se ne kryesine e Keshillit te Pergjithshem, qe ka per detyre te drejtoje mbarevajtjen e jetes se tij(pergatitjen per mbledhje, tematikat e tyre, te orientoje veprimtarine ne pergjithesi te KP dhe ne menyre te vecante, te vleresoje situata etj)

jane vetem rrogetare e emruar. Shtroj pyetjen : ku është vleresimi i antaresise dhe ne kete forum qe duhet te afirmohet 100% ?

Ne qofte se shohim se ne cfare raporti qendrojne te zgjedhurit dhe vet KMSH dhe pastaj, me punojesit te emeruar, konflikt interesi nuk paraqitet asgje konkrete. Cdo lloj mareveshtje duhet te orientohet nga vetem interesi ne te mire publikut ne se jane te drejta e ne perputhje me vleren e tregut. Eshte prona vakuf, trajtimi i saj ajo qe e teston kete pike te rëndësishme te marredhenieve. Eshte e domosdoshme per te patur nje kapitull ne statut ku prona, trajtimi, cfrytezimi i saj, te jete sa me i qarte, pa ekuivoke. Ne fund te fundit ajo duhet te vihet ne sherbim te interesit te publikut ne cdo kohe, pa devijue nga rregullat e tradites islame dhe ligjet e ekonomise tregut

Si perfundim zgjedhjet do te behen te drejta, te ndershme atehere dhe vetem atehere kur antaresia si baza e themeli i KMSH te ngrihet ne nivelin qe i jep ligji.

Te gjitha keta rregulla duhet te pasqyrohen ne statut qe te mbeshtesin organizimin, funksionimin dhe veprimtarine e KMSH. Deri tani, e themi me keqardhje, mendimi juridik është i zbehte dhe qe ngarkon me pergjegjesi juristin e emeruar ne kete institucion(. per te mos thene se është antiligjor qendrimi i tij) titullarin e KMSH

qe nuk ka kerkuar llogari per te vene ne vend ligjin me efektin e tij.

Shpresojme se ne ndergjegjen e drejtuesve te ketij institucioni shume te rëndësishem, , ka mbetur dicka qe te mund te reflektojne dhe t'arrijne te marrim masa per ndryshime :me pare ne statut dhe me pas ne veprimtarine e gjithanshme te tyre. Ne fund te gjithë do te gjykohe mi e vlersohemi nga aritjet qe kemi e nga qellimi qe kemi patur.

Uroj me gjithë zemer ZOTI na udhezofte te gjithëve.

Hadi Bushati
Antar i Keshillit Pergjithshem
Shkoder, 15 Qershor 2007

Vijon nga faqja 1

perpire te gjithë ekonomine shqiptare duke u perpjekur te privatizojne vete gjithshka qe është shqiptare dhe te ncerrin jashte loje konkurentet e tjere. Per ne shqiptaret renia e Albtelekomit ne duar te kompanise turke do te sjelle qe ne telefonini celulare do te hyje edhe nje operator i trete qe do te ule tarifat per bisedat e qytetarve ne menyre drastike dhe firmat greke AMC dhe Vodafon mund te marrin valixhet, sepse ditet e tyre per spekulim do te marrin fund.

Ka mundesi qe penalizimi i vazhdueshem i Turqise ne media dhe ne fjalorin politik ka te beje me politiken antiturke qe na serviri historia sllave e komunizmit te cilen e penalizoi edhe ish drejtori i arkivave Shaban Sinani qe deklaroi se shqitaret nuk kane luftuar gjithmone me turqit, por ka pase periudha te gjata qetesie, kur dy popujt kane jetuar ne paqe me njeri tjetrin.

Duhet te theksohet se edhe kryeministri turk, Erdogan, gjate nje vizite ne vendin tone, u kujtoi politikaneve dhe historianeve shqiptare ta rishikojne historine me perendorone turke, sidomos periudhen e Skendrbut sepse ka shume pasaktesira.

Por, duket se sugjerimet e kryeministrit turk rane ne vesh te shurdhet dhe sot te krijohet

idea se shqiptaret i kane amnistuar te gjithë pushtuesit e tij historike me perjashtim te Perendorise Osmane per te cilen thuhet se vetem ne kohen e saj shqiptarve iu dha mundesia te tregonin te gjithë vlerat e tyre, duke qene pjese e rëndësishme e ekesaj perendorie.

Brezi i diteve tona nuk mund te harroje qendrimin e qeverise turke ne vitin 1997, e cila deklaroi se kufinjte e Shqiperise jane si kufinjte e Turqise dhe kush e prek Shqiperine ka prekur Turqine dhe ndihma per Shqiperine do te vije nga toka duke i tmerruar ato forca dhe shtete qe i vune zjarrin Shqiperise ne vitin 1997. dhe njekohesisht u kujtoi te behngati per per lufte po e preken Shqiperine.

Prandaj ne, qe i dhame Telekomin turqeve te jemi te bindur, qe edhe po t, ia kishim falur, nuk do t, ia kishim lare miqesine, kujdesin dhe mbrojtjen te cilen ajo na garanton. Le te mos harrojme qe është vendi i vetem ne bote ku shqitaret nuk kan nevojë per viza kur udhetojme drejt Turqise, ketij vendi me te cilin na lidh historia e kaluar dhe vazhdon te na lidhe historia e diteve tona

SHOQATAT MUSLIMANE JANE TE PAVARURA DHE TE APROVUARA ME LIGJ



Problemet dhe shqetesimet me te cilat po peballen sot muslimanet ne Shqiperi dhe me gjere, kane bere te domozdoshme edhe aktivizimin e shoqatave muslimane, qe edhe ato te japim mdihmesen e tyre ne dhenin e zgjidhjeve qe jane optimale per interesat e komunitetit musliman, kur kemi parasysh se pikerisht keto interesa po behen pre e segmenteve te caktuara mrenda dhe jashte ketij komuniteti te cilet jene te interesuar qe ky komunitet te varferohet ekonomikisht dhe te rrudhet fetarisht dhe politikisht.

Por, angazhimi i shoqatave muslimane ne menyre publike do te ishte fiktiv dhe pa vlere ne qofte se ato nuk do te vepronin mrenda kuadrit ligjor i cili u garanton atyre veprimtari te pavarur, duke i shpetuar keshtu tutorit qe kerkon t, i beje nje atavizem te tij Duke e cuar mendimin me tej, ne i bejme me dije muslimaneve se Forumi Musliman Shqiptar, Shoqata Bamirese Islame Shoqata Intelktualeve Shqiptar Kultura Islame dhe Klubi Kulturor Drita jane te aprovuara me vendim gjykate ku edhe eshte sanksionuar karakteri i tyre i pavarur si shoqata joqeveritare ashtu si KMSH i cili

ka statusin e nje shoqate joqeveritare Objektivi kryesor i shoqatave muslimane ne Shqiperi eshte mbrojtja e interesave te muslimaneve, kur keto interesa te jene te cenuara duke kujtuar gamen e pafund te ketyre interesave te cilat kushdo i sheh dhe e kupton se jane te cenuara me shume se asnjehere tjeter. E verteta eshte se kete detyrim, qe se pari eshte fetar, shoqatat muslimane e kane realizuar dhe jane ne pritje qe keto qendrimet te jene vije e paluhatur e strategjise se tyre sot dhe ne te ardhmen sepse, me sa shihet, muslimanet do te kene shume pune ne angazhimet per te mbrojtur interesat e tyre.

Qendrimi qe kane mbajtur shoqatat muslimane per mbrojtjen e interesave te muslimaneve u ka lene shije te ndryshme atyre qe i kane percjelle keto qendrimet. Eshte e qarte se muslimaneve keto qendrimet u kane rritur perkushtimin ndaj fese islame, ndersa atyre, qe e quajne hapësirën e muslimaneve nje prone te tyre ku vetem ato mund te bejne ligjin shija qe kane provuar nga keto qendrimet ka qene shume e hidhur, sepse shoqatat muslimane nuk i shohin si partnere, por i trajtojne si kundërshtarë, duke hedhur keshtu hije dyshimi per menyren si keto perfaqesues ligjor te muslimaneve i mbrojne interesat e antaresise qe ato perfaqesojne

Muslimanet dhe mbare opinjoni publik kane pershendetur qendrimin mediatik te ketyre shoqatave permes konferencave te shtypit dhe te deklarave per problemin e bustit te nene Terezës, duke percaktuar vendosjen optimale te tij ne Shkoder dhe angazhimin e fuqishem ne mbrojtje te ceshtjes Bajraktari duke denoncuar me te drejte qendrimin antiislam te KMSH qe

realizoj me manipulime shkarkimin e Bashkim Bajraktarit qe kishte bere vetem nje faj te rende sipas KMSH,

Ai kishte mbrojtur pronat e muslimaneve dhe kishte mbrojtur dhe ceshtje te tjera qe kishin te benin me interesat e muslimaneve

Kuptohet se shoqatat muslimane nuk mund te

shkonin pas qerres se KMSH sepse me veprimet e tij KMSH po demtonte interesat e muslimaneve ne Shqiperi.

Shoqatat muslimane mbajten nje qendrim mbeshtetes per greven e urise qe bene besimtaret e xhamise se Tabakeve ne Tirane qe denoncuan shitjen e truadhit te vakufit biznesmeneve me cmime qesharake ne krahasim me ato te tregut, duke e detyruar

KMSH te beje perpjekje per te korigjuar kete veprim te gabuar financiar me pronat e vakufit. Prononcimi i shoqatave muslimane nuk behen ne emer te te gjithë muslimaneve, por vetem ne emer te anetarsise qe ato perfaqesojne dhe ansjelltas dhe KMSH duhet te deklarohet vetem per anetaresine qe ajo ka. Kjo vlen edhe per instancat derivate qe ajo ka. .

Qendrimi i drejte i shoqatave muslimane beri qe ato te penalizohen nga qeveritare dhe nga vete KMSH qe e ka detyre, sipas statusit te tij, te ndihmoje keto shoqata dhe te bashkepusojne me ato, sepse ishte qendrimi i ketyre shoqatave qe i ndergjegjesoi muslimanet per qendrimin e drejte qe duhet te mbajne dhe te gjithë ato e kane obligim mbrojtjen e interesave te muslimaneve ne Shqiperi dhe me gjere. Shoqata Bamirese Islame po nxerr numurin e dyte te gazetes Besimtari qe militon ne menyre te pavarur ne mbrojtje te interesave te muslimaneve dhe nuk ka strategji per te anashkaluar, ose per te dubluar KMSH

Ka informacione se KMSH po punon per ta bllokuar Besimtarin gje qe na shqeteson, sepse KMSH duhet te percjelle mediat e shkruara dhe vizive shqiptare dhe te huaja qe po e bejne cope islamit me akuza nga me te poshtrat, gjithmone te paverteta

dhe te mos gjuaj Besimtarin qe punon per besimtaret. Urretjtet personale dhe frika nga e verteta nuk jane tipare dhe veti te muslimaneve te vertete. Askush te mos kete frike se mund t, I fluturoje karrikeja, sepse Besimtari nuk ka strategji te tij levizjen e askujt nga karriga, por ai do te militoje qe karrigat te jene ne pozicionin fetar per te cilin edhe jane te obliguar.

Thirrjet kercenuese te kryetarit te Komitetit te Kulteve fetare Rasim Hasanaj ndaj shoqatave muslimane dhe sidomos te KMSH qe kerkon ndihmen e shtetit per te zhdukur shoqatat muslimane me kontrolle financash, tregojne se shoqatat muslimane i kane arritur piketat qe kane vene, sepse ato tashme jane bere faktor te cilin mediat po e pranojne si te tille dhe po keshtu besimtaret muslimane po i percjellin me shume interes dhe besim prononcimet e ketyre shoqatave per probleme qe kane lidhje me interesat e muslimaneve shqiptare. Shoqatat muslimane financohen nga anetarsia e besitarve muslimane qe bejne pjese ne keto shoqata dhe nuk eshte kurre e paligjshme, po te kene mundesi, te marrin edhe fondee dhurate nga shoqata simotra muslimane edhe nga jashte Shqiperise. sepse jo cdo dhurate eshte financim terrorist me te cilin kerkoi te frkesoje KMSH shoqatat muslimane ne Shqiperi

Selim Gokaj Shkoder, me 12. 6. 2007

SEHIRXHINJ APO POLITIKANE

Sic dihet, Islami eshte fe, moral, besim dhe ligj, adhurim dhe udheheqje pa kurrfare pjesetimi dhe ndarjeje. Islami nuk lejon ndarjen ne mes te fese dhe te politikës dhe se e tere kjo, ne aspektin islam eshte obligim per besimtarin. Jeta eshte si nje lum prej te cilit nuk mund te ndahet dicka nga nga e tera. Politika eshte e lidhur me ekonomine dhe ky binom eshte i lidhur me

Edukaten, arsimin, sistemin informativ kulturen dhe po keshtu jeta shoqerore eshte e lidhur me ekonomine dhe se bashku jeta shoqerore dhe ajo ekonomike jane te lidhura me politiken, dukuri kjo qe eshte pjese shume erendesishme e fese.

Si cdo aspekt i jetes edhe politika e mirfillte, e bazuar ne revelaten hyjnore, nuk duhet te mbese e shkeputur nga feja, sepse revelata hyjnore perfshin cdo aspekt te jetes dhe politika kunsiderohet si nje program jete per sejcilin besimtar musliman

politika, qe ka lidhje me islamit, eshte nje politike e drejte dhe ne asnje rast Islami nuk ka lidhje me politiken e padrejte

Cili eshte qendrimi i Islamit ndaj politikës? A ka lidhje feja islame me politiken? A duhet te jesh hoxhe apo politikan, apo te jesh hoxhe dhe politikan? A duhet qe muslimani te merret me politike te mirfillte apo jo?.

Keto jane ceshtje qe kane te bejne me ekzistencen e muslimaneve sot ne bote.. Islami, i zbritur nga Allahu xh. sh. dhe i trashëguar nga Profeti a. s., ka lidhje me politiken e drejte dhe kjo eshte nder vlerat me te larta te fese islame. Teoria e ndarjes se fese islame nga politika eshte pjese e sulmit qe behet sot kunder fese islame, e cila i kundervihet kesaj teorie, sepae feja islame perfshin shume ceshtje qe jane pjese e politikës sic jane parimet e besimi, moral, i lidhjet e njerezve me njeri tjetrin

Filozofia e politikës ne islam eshte ndertuar mbi parimin se politikan dhe cfare ka ai ne vartesi, jane ne duar e Allahut i cili e ka shpallur islamit fe hyjnore.

Mjafton te degjojme urdherin e Allahut per Profetin tone, Muhamedin a. s. si dhe per mbare njerezimin e ne vecanti per muslimanet, te cilet i urdheron te gjykojne me ligjin e Allahut i cili eshte Kurani ku thuhet" Ta zbritem qe edhe ti gjykosh me ate qe te zbriti Allahu dhe mos ndiq deshirat e tyre dhe ruaju rrezikut te tyre qe te mos te shmangin nga nje pjese e asaj qe ta

Zbriti Allahu;;;;A thua mos po kerkojne gjykimin e kohes se injorances, por per nje popull qe bindshem beson, a ka gjykim me te mire se i Allahut[EL-Maide, 49-50]

Allahu na urdheron ne, perms Profetit a. s, te qeverisim me ligjin hyjnor dhe AI i ka konsideruar ligjet njerezore, qe ndryshojne nga shekulli ne shekull dhe nga viti ne vit, si ligje jo te plota per ato qe besojne bindshem ne ligjet hyjnore, sepse ligjet e shpikura nga njerezit, sado te persosura qe te jene ato nuk mund te krahasohen me ligjet hyjnore

Pa dyshim, qeverisja dhe drejtimi i kesaj qeverisjeje na obligon qe angazhohemi ne nje politike te ndershme dhe te sinqerte si u theksua ne ajetet e mesiperme pa te cilen muslimanet nuk do te realizojne progresin dhe perparimin.

Si mund te thuhet se muslimani nuk duhet ta lidhe politiken me fene, kur vete Allahu xh. sh. e ka konsideruar angazhimin ne nje politike te paster nje prej parimeve baze te fese islame. Mjerisht, sot kemi arritur ne ate peridudhe, per te cilen, Profeti Muhamedi a. s. thoshte; "Do te vije nje kohe, qe njerezit do te quajne te miren te keqe dhe te keqen te mire"

Islami i vertete nuk mund te konsiderohet dhe te kuptohet i shkeputur nga politika, sepse ai ka ngarkuar cdo musliman te devotshem per te mira dhe te ndaloje ate nga te keqat duke e urdheruar te keshilloje pushtetare e politikane qe te ndalojne padrejtesite

Vijon ne faqen 5



ISLAMI PER GJAKMARRJEN

Allahu xh. sh e krijoi njeriun te shijojte kete jete, i lire ne obligimet e tij, per te fituar kenaqesine e Krijuesit ne kete dynja dhe ne ahiret. Para se te krijonte Ademin a. s. , meleket i thane Allahut xh. sh. ;"A do te vesh ne te(toke) ate qe ben shrrregullime dhe derdh gjaqet e na te madherojme ty me lavderimin tand dhe plotesisht e adhurojme!

Ai tha;"Une di ate qe ju nuk e dini'. Pasi qe Zoti i madheruar e krijoi Ademin a. s., e prezantoi para melekeve dhe para shejtanit per te nderuar kete krijese. Meleket e nderuan me respek, por shejtani u tregua qibar dhe Zoti e mallkoi per mendjemadhesine e treguar ndaj Ademit a, s deri ne kjamet.. Per kete arsye, shejtani eshte armiku kryesor i njeriut dhe me te gjitha mjetet e tij, ai perpiqet te gaboje njeriun dhe ta hedhe ne gremine ne te dy jetet e tij.

Nje nga veprat me te dashura te shejtanit, eshte te fuse ne grindje njerezit , duke synuar te arrije ne ate shkalle, sa njerezit t. ia marrin jeten njeri tjetrit pa te drejte, gje qe, shejtani e beri qe ne fillimet e jetes se njeriut

, Njeri nga djemte e Ademit a. s. vret vellaun e tij, sepse ai donte te martohej me motren qe nuk i takonte ta bente. . Ne kete menyre. ai arriti te krijojte nje gjelozi ne mes te tyre , duke arritur qe Kabili te vrase vllaun e vet, Habilin. Ketu eshte rregjistruar vrasja e pare ne historine njerezore. dhe pikerisht ketu eshte edhe fillimi i gjakderdhjes ndaj te pafajshmeve, qe u shtua me vone me shtimn e njerezimit.

te cilen historia e ke vertetuar me se miri. ne lufterat e pafundme, qe jane bere ne dem te atyre qe jane me te dobet.,

Allahu, xh, sh, duke pare nevojen e njerezimit per udhezim te vazhdueshem, dergoi me mijra pejgamere, per t, udhezuar nga e mira dhe per t, i ndaluar nga e keqja, qe njerezit ta shfrytezojne kete jete ne dobi te tyre si eshte edhe udhezimi i Krijuesit dhe per asnje arsye mos t, I a marrin jeten kujt pa te drejte Me ardhjen e profetit te fundit per njerezimin, Muhamedit a. s, Krijuesi e urdheroi te garantoje paqe dhe harmoni ne mes te njerezve dhe me cdo kusht te ndalonte gjakderdhjen ne mes te tyre dhe ne vecanti ne mes te besimtarve muslimne.

Populli arab, si te gjitha popujt e asaj kohe, ishte i zhytur ne nje injorence te madhe, ku vrasja ishte nje zakon i rendomte. Njerezit vriteshin per gjera shume te thjeshta dhe ordinere.. Vrasjet e gjakderdhja ishin fenomene te dites.

Por, me ardhjen e Islamit, Allahu xh, sh, vendosi, permes Kuranit Famelarte, ligje dhe rregulla teper te forta per te parandaluar ketij fenomeni teper te demshem per shoqerine njerezore.

Ne suren Nisa, Allahu xh. sh. urdheron ;'Oju njerez! Mos e hani mallin e njeri tjetrit ne menyre te palejuar, perpos tregetise qe keni pajtushmerine ne mes te vehtes dhe mos mytni vehten tuaj(duke mbytur njeri tjetrin).. Vertet

Allahu eshte i meshirshem per jete(29. 3)

Kush mbyti nje besimtar me qellim, denimi i tij eshte xhehnemi ne te cilin do te jete pergjithmone, Allahu eshte i hidheruar ndaj tij dhe e ka mallkuar dhe i ka pergaditur nje denim te madh.

Asnje besimtari nuk i eshte lejuar te mbyse besimtarin tjetër, perpos gabimisht e kush e mbyti gabimisht nje besimtar, ai ehte i obliguar te liroje nje rob besimtar dhe shpagimin e gjakut t, ia dergoje familjes se tij, perpos se ia fal familja gjakun, Ne qofe se ai i imbyturi gabimisht, i takon nje populli, qe eshte armik i juaji,. atehere eshte obligim lirimi vetem i nje robi besimtar.

Keto ajete dhe shume ajete te tjera ne Kuranin famelarte vendosin rregulla te forta, qe fenomeni i vrasjes te kufizohet ne maksimum dhe zakoni i gjakmarrjes te lihet pas, si zakoni i idhujtarise

Duke anashkaluar urdherat e Allahut xh. sh. ne Kuranin Famelarte dhe udhezimet e Pejgamerit a. s. e duke mos i zbatuar rregullat e Sheriatit Islam, ne ditet tona, eshte shtuar ne permasa dramatike vrasja dhe gjakmarrja. Sot njeriu vritet pa hak per qellime me ordinere

dhe shume nga vrasjet nuk denohen nga organet e shtetit dhe nje pjese e mire e krimineleve arratisen nga vendi i krimit per, t, i shpetuar drejtesise. Ne vendin tone, ky fenomen eshte shume aktual dhe, duke mos vepruar ligji islam i Sheriati, sot kemi nje perhapjen edhe me te madhe te ketij fenomeni. Ne zonen Veriore te Shqiperie, njerezit vazhdoje te zbatojne gjakmarrjen me nje egersi te jashtzakonshme, duke u mbeshtetur te Kanuni i Leke Dukagjinit

Kanunin, me keto rregulla qe ai ka, nuk e ka njohur as nuk e njeh. Sherjati islam, sepse ky kanun lejon gjakmarrjen, jo vetem tek vrasesi, por edhe tek njerezit e tjere te fisit, duke i dhene nje shtrirje krimit dhe fenomenit te gjakmarrjes dhe duke cuarkeshtu ne shfarosjen e familjeve te tera, ku shumica jane njerez te pafajshem

Ky kanun ka nje pergjegjesi shume te madhe, sepse i nxit njerezit te bejne vetgjegjesi e cila eshte veper e jashtligjshme dhe ajo qe ka shume rendesi eshte se vetegjegjesia eshte nje zgjidhe, qe eshte shume larg nje vendimi qe ka mrenda drejtesine.

Feja islame e quan veprimin e vetegjegjesise nje vrasje me paramendim. Ne Haxhin i lamtumires, Muhamedi a, s thote se jeta e sejcilit nga ju eshte e shenjte. Prandaj, gjakmarrjen ne e konsiderojme nje fenomen te paligjshem, qe kercenon shoqerine njerezore.

Fenomeni i gjakmarrjes ka sjelle pasoja te hidhura dhe te dhimshme, qe reflektohen tek ngujimi i qindra famljeve. Qindra femije jane te ngujuar dhe jetojne me ankthin se e kane jeten te kercenuar. Kjo drame e rende sociale sjell qe keto familje te jetojne ne kushte te renda ekonomike, te cilat vazhdojne te rendohen,

duke i cuar keto familje drejt mjerimit dhe te nje urie te tejskajshme

Islami, kete gjendje e quan dhune social-ekonomike te papranueshme dhe i hedh poshte keto zakone duke dhene zgjidhje qe e sherojne kete semndje te rrezikshme shoqerore

Sipas fese islame dhe ligjit te saj, qe eshte Sheriati, vrasesi, qe i ka marre jeten tjetrit pa te drejte nje njeriu, duhet te ekzekutohet ne menyre ligjore, veprim qe duhet ta bejne organet shteterore. Islami nuk njeh edukim per kriminelin, as pendimin e kriminelit.

Prandaj, Islami parashikon, pa ekuivok, denim kapital per kriminelin. Islami, duke pranuar drejtesine shteterore per te denuar kriminelin, distancohet hapur nga kanuni, qe i hap rrugen nje dhune qe ka vetem spiralin e rritjes e cila merr pa te drejte nje numur te pafund viktimash. Per te zhukur ndjenjen e hakmarrjes tek njerezit e viktimes, ligji islam ka krijuar hapësira te tilla si; te drejten qe njerezit e viktimes mund te marrin pjese ne ekzekutimin e kriminelit, vendim qe eshte marre me pare nga drejtesia shteterore.

